



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 597 , datë 24.7.2026

P Ë R

**PROPOZIMIN E PROJEKTLIGJIT “PËR RATIFIKIMIN
E MARRËVESHJES SË HUAS DIREKTE,
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR
NGA MINISTRIA E FINANCËVE, DHE SHTETEVE TË BASHKUARA
TË AMERIKËS, PËRFAQËSUAR NGA AGJENCIA
E BASHKËPUNITIT PËR SIGURINË E MBROJTJES (DSCA),
NË KUADËR TË FINANCIMIT TË JASHTËM USHTARAK (FMF)”**

Në mbështetje të neneve 81, pika 1, 83, pika 2, e 100, të Kushtetutës, dhe të nenit 17, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Propozimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas direkte, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, përfaqësuar nga Agjencia e Bashkëpunimit për Sigurinë e Mbrojtjes (DSCA), në kuadër të financimit të jashtëm ushtarak (FMF)”, për shqyrtim dhe miratim, me procedurë të përshpejtuar, në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, sipas tekstit dhe relacionit, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

MINISTRI I FINANCËVE


PETRIT MALAJ

NR.PROT. 470511
DATË 24.7.2026

KUVENDIT
MINISTRISË SË FINANCAVE

Sekretari i Përgjithshëm


Elsonida RAMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKT LIGJ

Nr. ____/2026

PËR

**RATIFIKIMIN MARRËVESHJES SË HUAS DIREKTE,
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR
NGA MINISTRIA E FINANCEVE, DHE SHTETEVE TË BASHKUARA
TË AMERIKËS, PËRFAQËSUAR NGA AGJENCIA
E BASHKËPUNIMIT PËR SIGURINË E MBROJTJES (DSCA),
NË KUADËR TË FINANCIMIT TË JASHTËM USHTARAK (FMF)**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pikat 1 e 2, dhe 121, pika 1, shkronja “ç”, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikimin e marrëveshjes së huas direkte, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, përfaqësuar nga Agjencia e Bashkëpunimit për Sigurinë e Mbrojtjes (DSCA), në kuadër të financimit të jashtëm ushtarak (FMF), sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R I

NIKO PELESHI